



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



REPUBLIKA KOSOVA

12.05.2026

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL ORGANIZON

PANAIRIN E PRODUKTEVE BUJQËSORË DHE ARTIZANALE "KLINË 2026"

07-320-13005/26

### THIRRJE PËR APLIKIM

Në kuadër të Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë" Edicioni i 24-të, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural zgjedh ta pasurojë këtë festë me një dimension të rëndësishëm ekonomik e rural

#### Panairin e Produkteve Bujqësorë dhe Artizanale.

Ky panair është mundësia e prodhuesve vendorë për të treguar se toka e Klinës prodhon, dora e artizanit të saj krijon dhe ekonomia rurale e kësaj komune ka të ardhme. Është urë lidhëse mes traditës dhe tregut, mes fermerit dhe blerësit, mes Klinës dhe gjithë Kosovës.

Drejtoria fton të gjithë prodhuesit vendorë, fermerët, artizanët dhe gratë fermere të Komunës së Klinës dhe rajonit të aplikojnë për pjesëmarrje.

#### DETAJET E PANAIRIT

Datat	6, 7 dhe 8 Qershor 2026
Hapja zyrtare	E shtunë, 6 qershor 2026, ora 18:00
Vendi	Sheshi "Mujë Krasniqi" Klinë
Orari	Çdo ditë 18:00 – 22:00

#### KUSH MUND TË APLIKOJË

- Bizneset
- Prodhues të produkteve ushqimore artizanale, Prodhues bujqësorë, Prodhues të nënprodukteve të qumështit
- Artizanë (punime në dru, qëndisje, tekstil, zanate tradicionale)
- Gra fermere dhe kooperativa

#### KRITERET E PËRZGJEDHJES

- Përparësi: Gratë fermere, kooperativat e grave dhe prodhuesit e rinj që marrin pjesë për herë të parë.
- Prodhuesit me origjinë nga Komuna e Klinës dhe komunat fqinje kanë prioritet
- Cilësia dhe origjinaliteti i produktit, produkte autentike, vendore dhe të prodhuara vetë.
- Plotësimi i standardeve higjieniko-sanitare për produktet ushqimore dhe qumështore.

- Diversiteti i ekspozuesve, sigurohet përfaqësim nga të gjitha kategoritë e panairit.

#### ÇFARË OFROHET FALAS PËR ÇDO EKSPOZUES

- Tendë dhe tavolinë
- Energji elektrike dhe siguri gjatë tre ditëve
- Ekspozim para vizitorëve dhe mediave
- Promovim nëpërmjet kanaleve zyrtare të Komunës dhe rrjeteve sociale
- Mundësi lidhje me partnerë biznesi, blerës dhe institucione mbështetëse
- Mirënjohje zyrtare

#### SI TË APLIKONI

Afati i fundit: 25.05.2026, ora 16:00

- Online përmes emailit: panairibujqesorklina@gmail.com
- Fizikisht, Sporteli i Komunës së Klinës

Drejtoresha e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
ILIRJANA TOPLANAJ





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

## FORMULAR APLIKIMI

Panair i Produkteve Bujqësore dhe Artizanale "Klinë 2026"  
6, 7, 8 Qershor 2026 | Afati i aplikimit: 12.05.2026 deri 25.05.2026, ora 16:00

### PJESA I — TË DHËNAT E APLIKUESIT

Emri i plotë / Biznesi

Nr. regjistrimit (nëse ka)

Komuna / Fshati

Personi kontaktues

Numri i telefonit

Email

### PJESA II — PRODUKTET DHE KATEGORIA

Kategoria e aplikimit

Produktet që do të  
eksponohen

Origjina e produkteve

### PJESA III — NEVOJAT TEKNIKE

Madhësia e tendës

A keni nevojë për energji  
elektrike?

Vërejtje / kërkesa të veçanta

**PJESA IV — DEKLARATA DHE FIRMA**

Data e aplikimit

Nënshkrimi i aplikuesit

**Kategoritë e disponueshme (rrethoni kategorinë tuaj)**

Prodhues ushqimor	Prodhues qumështor	Prodhues bujqësor	Artizanal / Zanat	Grupa Fermere / Kooperativë
-------------------	--------------------	-------------------	-------------------	-----------------------------

**Formulari i plotësuar dorëzohet deri më 25 maj 2026, ora 16:00:**

- Fizikisht: Sporteli- Komuna e Klinës
- Email: [panairibujqesorklina@gmail.com](mailto:panairibujqesorklina@gmail.com)